

Minutat e Takimit te Komitetit te Rinovimit te MKV(procesi i dyte i rinovimit)

Date: 27.04. 2015

Pjesemarresit: Milva Ekonomi, Ylvi Selmani, Ledia Lazeri, Jonid Lamllari, Manjola Kola

Axhenda : Analiza e aplikimeve te dorezuara prane sekretariatit te MKV.

Dokumenta ekzistuese: Aplikimet e organizatave perfaqesuese per MSM, PID,dhe PKS.

Lidhur me procesin e shtyre te zgjedhjes nga grupet e përfaqësimit për :

I.Organizatave përfaqësuese për MSM, PID dhe PKS,

II. Shoqatat e Profesionistëve

dhe në ndjekje të procesit të miratuar nga Komiteti i Rinovimit te MKV, u ndoqën hapat e mëposhtëm:

MKV-ja ne mbledhjen e dates 17.04.2015, pasi shqyrtoi propozimin e Komitetit te Rinovimit te Anetaresise se MKV, vendosi shtytjen e procesit te aplikimit deri me date 26.04.2015

Shpallja e aplikimit përmes:

- Shpërndarjes së njoftimit me email tek anëtarët dhe bashkëpunëtorët e MKV date 19 Prill, 2015.
- Shpërndarjes me email tek mbi 250 kontakte të organizatave/institucioneve të ndryshme, date 19 Prill, 2015
- Njoftimi në website të MKV date 19-26 Prill ,2015
- Njoftimi në Gazetë Panorama, date 20 dhe 21 Prill, 2015.

Shqyrtimi i dokumentacionit nga sekretriati I MKV dhe Komiteti: 26-27 Prill, 2015

Mbledhja e Komitetit te Rinovimit date 27 Prill, 2015.

Sekretariati vuri ne dispozicion te anetareve te Komitetit te Rinovimit, aplikimet e paraqitura ne kete proces:

Organizatave përfaqësuese për MSM, PID dhe PKS (punonjëset komerciale të seksit):

Organizata e meposhteme shprehen interesin duke paraqitur dokumentacionin e tyre për këtë grupim:

1.Aksion Plus- Genci Mucollari ne cilesine e kandidatit, Erlind Plaku ne cilesine e zevendesuesit.

Dokumentacioni i kesaj organizate u analizua nga Komiteti i Rinovimit dhe u gjet korrekt ne plotesimin e kriterave dhe te dokumentave te kerkuara.

2.ProLGBT – Kristi Pinderi në cilësinë e kandidatit, Erjon Tela në cilësinë e zëvendësuesit (aplikuar ne round e pare te zgjedhjeve 23-31 Mars 2015).

Dokumentacioni i kesaj organizate u analizua nga Komiteti i Rinovimit dhe u gjet jo korrekt ne plotesimin e kriterave pasi mungon prova të funksionimit në mënyrë transparente dhe në respektim me ligjin (pagesa e taxave/tatimeve) si dhe jo korrekt ne paraqitjen e dokumentacionit te kerkuar (statuti i pjesshem).

3.ISOP –“Instituti i Studimit te Opinionit Publik” -Eris Dharmo në cilësinë e kandidates, dhe Emanuela Ismaili në cilësinë e zëvendësueses. (aplikuar ne round e pare te zgjedhjeve 23-31

Mars 2015).*Dokumentacioni i kesaj organizate u analizua nga Komiteti i Rinovimit dhe u gjet jo korrekt ne plotesimin e kriterëve pasi nuk mund te konsiderohet si perfaqesues i Grupeve te Riskut ne terren krahasuar me pese aplikimet e tjera qe u paraqiten ne roundin e dyte te aplikimit per anetaresi te Grupeve ne Risk.*

4.STOP AIDS- Arian Boci ne cilesine e kandidatit, Memo Boci ne cilesine e zevendesuesit.

Dokumentacioni i kesaj organizate u analizua nga Komiteti i Rinovimit dhe u gjet korrekt perkundrejt kriterëve dhe paraqitjes se dokumentave te kerkuara.

5.NCCS- Liliana Dango ne cilesine e kandidatit, Valentina Erindi ne cilesine e zevendesueses.

Dokumentacioni i kesaj organizate u analizua nga Komiteti i Rinovimit dhe u gjet korrekt perkundrejt kriterëve dhe paraqitjes se dokumentave te kerkuara .

6.PINK/LGBT PRO-Amarildo Fecanji ne cilesine e kandidatit, Artan Karoli ne cilesine e zevendesuesit.*Dokumentacioni i kesaj organizate u analizua nga Komiteti i Rinovimit dhe u gjet jo korrekt ne plotesimin e kriterëve pasi mungon prova të funksionimit në mënyrë transparente dhe në respektim me ligjin (pagesa e taxave/tatimeve).*

7.SEEP- “Edukimi Social dhe Mbrojtja e Mjedisit” -Simo Ribaj ne cilesine e kandidatit, Sigrida Hasanaj ne cilesine e zevendesuesit.

Dokumentacioni i kesaj organizate u analizua nga Komiteti i Rinovimit dhe u gjet jo korrekt ne plotesimin e kriterëve pasi nuk mund te konsiderohet si perfaqesues i Grupeve te Riskut ne terren, gjithashtu u gjet mangesi ne dokumentacionin e dorezuar lidhur me mosparaqitjen e Deklarates se Konfliktit te Interesit si organizate.

Lidhur me procesin e shtyre te zgjedhjes per:

II. Shoqatat e Profesionistëve,

Sekretariati i MKV beri sqarimin qe nuk ishte paraqitur asnje shprehje interesi per kete pozicion te MKV.

Komiteti i Rinovimit te MKV, gjykoi te jepte mundesine organizatave per plotesim dokumentacioni me ane te njoftimit me email nga ana e sekretariatit ne dt.28-29 Prill 2015. Gjithashtu gjykoi qe organizatat që do te *plotësojnë kriteret* dhe qe do te plotesojne korrektësisht *dokumentacionin* e kërkuar do te shkojne ne procesin e votimit te dt.5 Maj 2015 bazuar ne planin kohor te procesit te shtyre te rinovimit te MKV.